



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I BASHKISE SE QYTETIT KORÇE

Vendim

Nr 27 date 14/04/2010

“Për kalimin ne administrim te terreneve sportive te shkollave te qytetit Klubit Shumesportesh ” Skenderbeu“

Keshilli i Bashkise Korçe pasi mori ne shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Juridike ,bazuar ne nenin 32 te ligjit nr.8652 dt 31.07.2000 “Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore ” pika e), ne ligjin nr.8114 dt 28.03.1996 “Per Sportin” i ndryshuar, ligjin nr. 8744 date 22.02.2001 “Per transferimin e pronave te Paluajtshme Publike te Shtetit ne njesite e qeverisjes vendore,V.K.M-se nr.1532 dt. 19.11.2008 “Per miratimin e listes pefundimtare te pronave te paluajtshme publike shteterore,qe transferohen ne pronesi ose ne perdorim te Bashkise Korçe te Qarkut Korçe“

VENDOSI :

1. Te kaloje ne administrim te Klubit Shumesportesh Skenderbeu terrenet sportive te shkollave te qytetit sipas inventarit bashkengjitur ketij vendimi,per implementimin projekt-ideese per krijimin e Akademise Sportive per gjithë e kohen e vazhdimit te projektit.
2. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Përgjegjesi i Pronave Publike prane Bashkise Korçe dhe Klubi Shumesportesh “Skenderbeu “.
3. Detyrohet Klubi Shumesportesh “Skenderbeu” të lidhë marrëveshje me Drejtorinë Arsimore Rajonale dhe me shkollat përkatëse .
4. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere .

KRYETARI

Gjergji PENDAVINJI